



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, me 15 tetor 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Bojan Stojanović dhe Agim Veliu.

Munguan: Melihate Termkolli dhe Zulfi Merxha.

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend ditë:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 06.10.2008**
- 3. Shqyrtimi i Ligjit për Statusin Civil**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me piken e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 06.10. 2008

Procesverbali i mbledhjes së datës 06.10.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Ligjit për Statusin Civil

Kryesuesi, njoftoi anëtarët e komisionit se me vendim të Kryesisë së Kuvendit, komisioni ynë bashkë me Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, jemi ngarkuar për ta shqyrtuar këtë ligj. Ky ligj është një prej 18 ligjeve të pa nënshkruara nga PSSP-ja, që janë kthyer në Kuvend për rishqyrtim. Unë sipas një praktike të shqyrtimeve të ligjeve që kemi në komision kam propozuar deputeten znj. Melihate Termkolli referuese për këtë ligj. Por në mungese të saj do të emërojmë një referues tjetër.

Naim Maloku tha, në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit kam propozuar, që Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, bashkë me Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, të shqyrtojme së bashku këtë ligj. Propozoi që nga komisioni ynë të caktohen tre anëtarë, që të shqyrtojme këtë ligj bashkë me komisionin tjetër.

Si përfundim i kësaj pike u vendos që Naim Maloku, Bojan Stojanovič dhe një anëtar tjetër që do të caktohet me vonë të jen anëtarë të grupit punues për shqyrtimin e këtij ligji.

4. Të ndryshme

Kryesuesi njoftoi, se janë disa çështje në kuadër të kësaj pike. Fillimisht ai theksoi çështjen e raportit me rekomandime për situatën e sigurisë, të hartuar nga komisioni, të cilin Kryesia e Kuvendit disa herë është duke e hequr nga rendi i ditës. Kjo pikë mbledhjen e fundit të Kryesisë, është hequr nga rendi i ditës për të mos u diskutuar as në mbledhjen e radhës. Por ne do të kërkojmë forma tjera si ti procedojmë këto rekomandime në të ardhmen. Nuk besoj që ka arsye që këto rekomandime të mos shqyrtohen apo të shkojnë në seancë për diskutim.

Naim Maloku, shpjegoi se si kishte kaluar diskutimi rreth kësaj çështje në Kryesinë e Kuvendit dhe theksoi se kjo pikë ishte hequr me propozim të Kryetarit të Kuvendit dhe besoi se ai kishte një arsye për këtë. Ai tha që nuk është mirë të dërgohet serish për shqyrtim kjo pikë pa u sqaruar arsyet për tërheqjen e saj nga shqyrtimi.

Emrush Xhemajli, theksoi se pavarësisht nga mos shqyrtimi i Raportit në Kryesi të Kuvendit, konsideroj se komisioni e ka kryer punën e vet. Është mirë fakti se edhe përfaqësuesit nga opozita në Kryesinë e Kuvendit janë pajtuar që kjo pikë nuk ka nevojë të diskutohet, atëherë kjo do të thotë se gjithçka është në rregull.

Naim Maloku tha, ne e kemi konsultuar Kryetarin e Kuvendit, ai ka thënë se nuk ka ndonjë presion nga jashtë, por nuk ka arsye më shumë. Unë në komision nuk jam opozitë por jam anëtar i komisionit dhe e mbroj atë që vendoset në komision.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se Komisioni ka qenë unik sa i përket këtyre rekomandimeve. Ai shtoi se e kishin thirrur personalisht nga zyra ICO për të sqaruar nëse komisioni ka qenë unik për këto rekomandime. Komisioni s'ka rekomanduar asgjë tjetër veç respektimit të Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Gani Geci, theksoi se këto rekomandime duhet të diskutohen në seancë. Parlamenti i Kosovës nuk ka pse të frikësohet për të diskutuar për gjendjen e sigurisë. Këto shtyrje nuk besoj se janë të rastësishme. Ai theksoi se ne kemi miratuar Kushtetutën në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare. Të kalojnë 8 muaj dhe Kuvendi i Kosovës të mos debatojë për shtatën e sigurisë nuk është në rregull. Ne duhet të kërkojmë që këto rekomandime të dalin në seancë dhe të debatohet për situatën e sigurisë.

Zafir Berisha- theksoi se nuk është mirë që Kuvendi i Kosovës, të mos marr për bazë rekomandimet e komisionit për siguri, e të mos debatojë për sigurinë. Mbështes idenë që këto rekomandime të debatohen në seancë.

Kryesuesi, duke përmbyllur diskutimet rreth kësaj çështje theksoi se do ti procedojmë edhe një herë këto rekomandime Kryesisë së Kuvendit, me kërkesë për debat në seancë.

Një tjetër çështje që kryesuesi njoftoi anëtarë e komisionit ishte një takim që, së shpejti do të organizohet me Ministrin e FSK-së, z. Fehmi Mujota. Ku do të diskutohet për rrjedhën e procesit të konsolidimit të kësaj ministrie, dhe transformimit të TMK-së. Komisioni vendosi që ky takim të mbahet me datë 23 tetor.

Çështje tjetër që u diskutuar ishte propozimi i OSBE-së, që në bashkëpunim me OJQ-KIPRED, që përfshinë disa vizita të komisionit në teren, me popullatë të përzier dhe unë propozoj që të merremi vesh se si e shohim këtë projekt. Nëse pajtoheni atëherë mbledhjen tjetër, do të ftojme në komision përfaqësuesin e KIPRED-it për të prezantuar projektin në Komision. Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit

